

Data 27/10/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45211300-2
Punime ndërtimi për shtëpi**

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,754,770 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, sipas përcaktimeve në pikën 2.3 në shtojcën 7 dhe me anë të paraqitjes prej tyre të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nese bilancet e dy viteve te njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

*Shëmin:Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin*

ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike",etj.

2.2.3 Një dokument lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërteton se subjekti i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 dhe për keestet e maturuara te vitit 2023 , referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin për te gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas ekstratit te QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit te vetedeklarimit sipas shtojcës 8 ne DST,dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shënim : Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për

sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) *Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorëzim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

Shënim:*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses,përqindjen e punimeve në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik,etj.*

b) *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm ku të shënohen vlera, afat i i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 shoqëruar me;
2. Kontrate Sipërmarrje;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
6. Çertifikaten e marrjes në dorëzim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 42, në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvujtë e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit si edhe mbështetur në LPP dhe në RRPP.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

- **N.P – 3 -A** (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensë e mëposhtme:**
 - **N.S- 1 A** (Punime për prishjen e ndërtimeve)
 - **N.S- 4- A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)
 - **N.S-14 A** (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në liçencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në liçencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë liçencën sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi", pikat e liçensës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilin kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

N.P – 3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)	Percaktimet ne preventiv (suvatime ,shtresa betoni, shtresa lluster cemento etj)	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S- 1	(Punime për prishjen e ndërtimeve)	Percaktimet ne preventiv(prishje çatie etj	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S.- 4	(Punime të rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Percaktimet ne preventive (trare tavani lende e sharruar, tavan fiber plastike, dritare duralumini, dyer druri etj)	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S-14	(Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)	Percaktimet ne preventiv punimet e linjave elektrike	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencën e shoqërisë për këtë objekt të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Korrik 2023-Shtator 2023 si më poshtë:

- Inxhinier elektrik 1 (një)
- Inxhinier ndërtimi 1 (një)

Një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.3 për kualifikim, janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarinimin e mësipërm.

Kriteri sipas pikes 2.3.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në perlllogaritjen e oreve të punës, kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmerine të realizimit sa më shpejt të objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë të përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesit Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Është kërkuar Inxhinier Elektrik, pasi është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të instalimeve dhe punimeve elektrike në kantier, është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij rrjeti gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, si dhe është përgjegjës për çdo problematikë në terren, në konstatimin dhe riparimin (në rast të dëmtimeve të mundshme) të çdo rasti të shfaqur gjatë punimeve në zbatimin e plotë të kontratës pasi ka punime për zvendesimin e linjave elektrike.

Është kërkuar Inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: shtresa betoni, shtresa te jashtme dhe te brendshme, shtresa lluster cemento si dhe punime strukturore sic janë punimet konstruksioneve metalike të thjeshta, trare e arkitrare, tavane, mbulim çatie me panele sanduiç etj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar si staf teknik të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional si dhe certifikata të sigurimit teknik të leshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2023 - Shtator 2023 minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik ndërtimi 1 (një)
- Punonjës Murator 3 (tre)
- Punonjës Suvaxhi 5 (pesë)
- Punonjës Hidroizolues 2 (dy)
- Punonjës Bojaxhi 2 (dy)
- Punonjës Hidraulike 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 2 (dy)
- Punonjës Pllakashtrues 4 (katër)
- Punonjës duralumini 2 (dy)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- certifikatë të sigurimit teknik e vlefshme, lëshuar nga institucione të autorizuara nga ISHTI e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë; (ose ekuivalente)
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.
-

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1				
2				
3..				

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 2.3.7, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”(i ndryshuar). Për këtë duhet të paraqitet diploma/çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, e njohur në Republikën e Shqipërisë , kontratë individuale pune të vlefshme si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës pjesë e stafit te shoqërisë të jete i pajisur me çertifikate “Ekspert Zjarrfikës”, lëshuar nga MZSH si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë per periudhen korrik 2023-shtator 2023 *ose* të jetë i kontraktuar për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës .
Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:
 - a) Kontrate pune;
 - b) diplome/certificate
- Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar **një mjek** të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim.

Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë dhe urdher mjeku.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse .

Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2023-shtator 2023.

Këto kritere konsiderohent të përmbushura me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë: 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në pune” i ndryshuar, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës..

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **25 (njëzetë e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve per periudhen korrik 2023- shtator 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshte :

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën Korrik 2023 - Shtator 2023
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2023 - Shtator 2023

Ky kriter konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim: Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose të noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, brenda afatit nga dërgimi i njoftimit për paraqitjen e tyre.

Argumentimi: Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 25 punonjës, për të paktën korrik 2023- shtator 2023, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/ç, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për periudhën 22 ditë, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve etj, duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve dhe shpërndarjen gjeografike të shtëpive në njësi të ndryshme administrative.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga institucionet përkatëse për lëshimin e licencave, Kodi III.2.B "Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis" me emërtim përshkruar të veprimtarisë "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane", sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi : Sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose e kuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë :

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”,
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ”
- Certifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”,

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë sipas akt-marrëveshjes

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësitë, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Çertifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Është tepër e rëndësishme që operatorët ekonomik ofertues, si zbatues të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të mjedisit, të cilët janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë / broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eveose skedat teknike, për materialet që do të ofrohen respektivisht, elektrike, pllaka, boja, dyer dhe dritare,të shoqëruar me çertifikatë/deklaratë konfirmimiti CE ose çertifikata cilësise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilën, me specifikimet përkatëse të markuara , në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat e specifikimeve teknike në DT.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi : Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë dhe/ose dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues, kapaciteti total mbajtës	në pronësi ose me qira	Copë 1

	minimumi 5 ton		
2	Kamionçinë me kapacitet total mbajtës deri 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Prerëse pllakash (troko)	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Cope 1
7	Kazma	në pronësi ose me qira	Copë 3
8	Balandez me kabëll	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Çekiç	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Shkallë	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Elektrogur	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Trapan	në pronësi ose me qira	Copë 2

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"*(i ndryshuar)* me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 1 (një) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë
- Karroca dore minimumi 2 (dy) copë
- Tabela paralajmëruese përsigurinë në objekt minimumi 2 (dy) copë
- Fikse zjarri 2 (dy) copë
- Jelekë minimum 15 (pesëmbëdhjetë) copë

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);

b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa më sipër, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet mbi makineritë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon.... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Sqarim lidhur me kerkesen e mjeteve te mesiperme:

- 1) *Kamiona vetshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 5 ton, është i nevojshëm për transportimin e materiale të krijuara nga prishja e cativë me rrasa guri*
- 2) *Kamioncine me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton, ky mjet përdoret për materialet me peshë specifike me të vogël se materialet e prishjes, gjithashtu janë të domosdoshëm për aksesin e tyre në gjerësi të kufizuara të rrugëve brenda lagjeve .*
- 3) *Matrapik për thyerje betoni, ky mjet është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të prishjes*
- 4) *Gjeneratori, i nevojshëm për furnizimin me energji elektrike gjatë momenteve të mungesës së energjisë nga rrjeti si dhe gjatë nevojës për furnizim me energji elektrike të veglave të punës në pamundësi të lidhjes me rrjetin energjistik ekzistues.*
- 5) *Prerese e pllakave (troko) nevojitet për arsye se në preventiva janë parashikuar zera punimesh për shtrimin e pllakave*
- 6) *Betoniere është e nevojshme për përparatjen e betonit për shtresat e betonit C-7/10*
- 7) *Trapan i nevojshëm për shpime muri dhe montime të ndryshme gjatë punimeve*
- 8) *mjetet e tjera të kërkuara si balandezi me kabëll ,çekiçi,shkallët ,elektroguri nevojiten gjatë punimeve të ndryshme.*

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.